

VENDIM
Nr.510, datë 8.8.2007

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM AVOKATIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE TË DISA
MJEDISEVE TË NDËRTESES (GODINËS) SË ISH-INIMA-S**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim Avokatit të Prokurimeve Publike të disa mjediseve, në katin e parë, të ndërtesës së ish-INIMA-s, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Kryeministria dhe Avokati i Prokurimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SIPERFAQE NE PERDORIM TE AVOKATIT TE PROKURIMEVE PUBLIKE

